

URDHËR
Nr. 71, datë 15.2.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË NR. 65,
DATË 9.2.2024, “PËR DELEGIM KOMPETENCE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 65, datë 9.2.2024, “Për delegim kompetence”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga ora 12:00 e datës 12.2.2024 deri në datën 15.2.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja